



Deklaratë për shtyp - 399/05/2020

20.05.2020
Faqa 1 nga 4

Hapja e sektorit të kujdesit ditor për fëmijë me veprimtari të rregullt të kufizuar

Zyra për shtyp e kancelarisë së shtetit
40213 Düsseldorf
Telefon 0211 837-1134
0211 837-1405
ose 0211 837-1151

Ministri Stamp: Duke filluar që nga data 8 Qershor të gjithë fëmijët mund të frekuentojnë në sasi të reduktuar mjediset e kujdesit ditor për fëmijë

presse@stk.nrw.de
www.land.nrw

Ministria e Fëmijëve, Familjes, Refugjatëve dhe Integritit ju komunikon:

Nordrhein-Westfalen po vazhdon në mënyrë konsistente planin e qartë për sa i përket hapjes së ngadaltë të sektorit të kujdesit ditor të fëmijëve, duke marrë në konsideratë mundësinë e infeksionit. Duke filluar që nga data 28 Maj 2020 do të zhvillohet siç është planifikuar hapja e qendrave të kujdesit ditor për fëmijët parashkollorë. Më 8 Qershor Nordrhein-Westfalen ndërmer hapin tjetër të planit të hapjes dhe kalon nga kujdesi emergjent i zgjeruar tek veprimtaria e rregullt e kufizuar. Të gjithë fëmijët mund të kthehen në sasi të kufizuar kohe tek qendrat e kujdesit ditor dhe tek personat të cilët merren me kujdesin ditor .

Ministri i Çështjeve Familjare Joachim Stamp: „E di që shumë familje kanë arritur limitet e kapacitetit të tyre në javët e fundit dhe se shumë fëmijë pa edukim të hershëm fëmijërie janë privuar çdo ditë nga mundësitë. Ishte synimi im i palëkundur, për t'i pajisur të gjithë fëmijët sa më shpejt të jetë e mundur me kujdes ditor, për sa kohë që kjo gjë është e justifikueshme. Si rrjedhim, jam shumë i kënaqur që duke patur parasysh ndodhinë në ulje të infeksionit, mund të ndërmarrim hapin tjetër në planin tonë të hapjes nga kujdesi emergjent i zgjeruar tek veprimtaria e rregullt e kufizuar.“

Me rastin e rënies së numrave të infeksionit, Ministria e Çështjeve Familjare të Nordrhein-Westfalen përpunoi në një fazë të hershme propozime konceptuale, se si kujdesi ditor dhe qendrat e tjera të kujdesit ditor mund të funksionojnë në kohën e koronavirusit me një numër në rritje të fëmijëve, me mbështetjen shkencore ndërdisiplinore për arsimin e fëmijëve dhe të higjienës. Veprimtaria e rregullt e kufizuar zhvillohet

brenda hapësirës së mbrojtjes nga infeksioni. Për më tepër, Republika i jep institucioneve sponsorizuese kohë për t'u përgatitur me kujdes për ndryshimin e nevojshëm. Veprimtaria e rregullt e kufizuar duke filluar që nga data 8 Qershor është e koordinuar ngushtë me komunat dhe të gjitha institucionet e tjera sponsorizuese, njëloj si tek të gjitha hapat e planit të hapjes.

Veprimtaria e rregullt e kufizuar e kujdesit ditor për fëmijë duke filluar nga data 8 Qershor:

- Masa e ndalimit të frekuentimit të qendrave të kujdesit ditor dhe të ambienteve të kujdesit ditor do të hiqet;
- Kujdesi i tanishëm emergjent do të shpërbëhet;
- Të gjithë fëmijët mund të frekuentojnë sërish qendrat e kujdesit ditor në një sasi të kufizuar prej 35, 25 dhe 15 orësh në javë në vend të 45, 35 dhe 25 orëve në javë ;
- Qendrat e kujdesit ditor të cilat për shkak të stafit dhe hapësirës janë në gjëndje të ofrojnë më shumë orë, mund ta realizojnë këtë gjë nëpërmjet marrëveshjes me autoritetet mbikëqyrëse përgjegjëse ;
- Qendrat e kujdesit ditor, të cilat e kanë të pamundur të ofrojnë këtë shërbim për shkak të situatës së stafit mund të devijojnë edhe më tutje, në marrëveshje me zyrën vendase të përkujdesjes së të rinjve; kjo duhet të ndodhë vetëm në raste të jashtëzakonshme;
- Rastet e mbrojtjes së fëmijëve dhe fëmijët veçanërisht në nevojë duhet të merren parasysh brenda mundësisë së kujdesit.

Veprimtaria e rregullt e kufizuar duke filluar nga data 8 Qershor e më tutje vlen gjithashtu për fëmijët, prindërit e së cilëve mund të përfitonin nga kujdesi më i zgjeruar në kujdesin e mëparshëm emergjent në raste individuale. Ministri i Çështjeve Familjare Stamp: „I shpreh solidaritetin tim të gjithë prindërve. Kalimi tek kjo fazë e re e veprimtarisë së rregullt të kufizuar do të jetë një sfidë madhore. Jo çdo gjë do të ndodhë pa probleme. Gatishmëria për të bërë lëshime është e nevojshme nga të gjitha palët.“

Hapja e qendrave të kujdesit ditor të fëmijëve me veprimtari të rregullt të kufizuar, ndodh me kufizime sasiore dhe cilësore. Standardet e Ligjit për Edukimin e Fëmijëve nuk arrihen dot ende dhe Fachkraftschlüssel nuk

përmbushet dot ende. Ministria e Çështjeve Familjare të Nordrhein-Westfalen ka përkufizuar standardet e qarta për veprimtarinë e rregullt të kufizuar:

- Duhet të ketë vetëm grupe fikse, jo hapësira të hapura;
- Në secilin grup do të përcaktohet minimalisht një specialist
- Grupet janë për më tepër fizikisht të ndarë;
- Të gjitha kontaktet duhet të jenë të gjurmueshme, planet e higjienës duhet të mbikqyren.

Masa për frekuentimin e ambienteve të personave që merren me kujdesin ditor hiqet gjithashtu duke filluar nga data 8 Qershor. Si parim, të gjithë fëmijët mund të kthehen tek personat që merren me kujdesin ditor. Gjithsesi, duke qenë se jo të gjitha burimet janë të gatshme në këtë drejtim, mundësia e kujdesit mund të jetë e reduktuar.

Ministria e Çështjeve Familjare po e shoqëron me monitorim shkencor kalimin nga kujdesi emergjent i zgjeruar në një veprimtari të rregullt të kufizuar sipas një komune model. Çdo javë disa mijëra fëmijë dhe specialistë testohen në qendrat e kujdesit për fëmijë dhe ndodhia e infeksionit monitorohet dhe vlerësohet ngushtë.

Në një monitorim të mëtejshëm shkencor, masat mbrojtëse janë ekzaminuar nga një pikëpamje mjekësore profesionale dhe është kontrolluar shkalla në të cilën shëndeti dhe siguria profesionale dhe masat e higjienës janë efektive në mbrojtjen e punonjësve dhe fëmijëve.

Ministri i Çështjeve Familjare Stamp: „Ne i kemi parasysh shqetësimet e punonjësve tanë. Kjo është diçka shumë e rëndësishme për mua. Për këtë arsye, jo vetëm që kemi zgjedhur paraprakisht një sasi kohe për përgatitje por gjithashtu do të mundësojmë mbështetje konkrete për punën e qendrave të kujdesit ditor në plan lokal.“

Kjo përfshin:

- Dërgimin e 2 miliona maskave FFP-2 dhe 3 miliona maskave OP tek zyrat për përkujdesjen e të rinjve si ndihmë fillestare brenda hapësirës së masave të shëndetit dhe sigurisë në punë,
- Kontribuim financiar tek institucionet sponsorizuese për të kompensuar kostot e jashtëzakonshme shtesë të cilat lindin nga masat e shëndetit dhe sigurisë në punë,

- Qendër konsultimi telefonike për të gjithë menaxherët e qendrave të kujdesit ditor për t'ju përgjigjur në mënyrë kompetente pyetjeve për higjienën dhe për masat e sigurisë dhe të shëndetit në punë,
- Program për rekrutimin e stafit, me qëllim rekrutimin e stafit ndihmës për qendrat e kujdesit ditor për të lehtësuar barrën e stafit lokal të arsimit (për shembull larja e duarve, veshja dhe heqja e këpucëve).

Ministri i Çështjeve Familjare Stamp: „Hapi i cili po hedhim është një sfidë e madhe për të gjithë personat e përfshirë. Ne po i qasemi në mënyrë të planifikuar, të përgjegjshme dhe të monitoruar shkencërisht.“ Faza e veprimtarisë së rregullt të kufizuar është planifikuar të zgjasë deri në 31 Gusht 2020. Bazuar në gjetjet shkencore, do të merret një vendim për hapat e tjerë në mes të gushtit.

Na ndiqni në rrjetet sociale:

Twitter: [@chancenrw](#)

Facebook: [Chancen NRW](#)

Instagram: [chancen_nrw](#)

YouTube: [Chancen NRW](#)

Nëse keni pyetje të mëtejshme, ju lutemi kontaktoni zyrën e shtypit të Ministrisë së Fëmijëve, Familjes, Refugjatëve dhe Integritetit, Telefon 0211 837-2417.

Kjo deklaratë për shtyp është gjithashtu në dispozicion në internet në adresën e internetit të qeverisë së Republikës www.land.nrw

[Njoftim për mbrojtjen e të dhënave në lidhje me rrjetet sociale](#)